


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE - TIRANE
N. 7778 Rep.
N. 534 Kol.

PULLE TAKSE



KONTRATE SHITJE

/i pjeseve te kapitalit te shoqerise/

Sot, me daten 25.06.04....., perpara meje noterit, Agim Xh. Robo, anetar i Dhomes se Notereve, Tirane, ne zyren noteriale, ne Rrugen Ismail Qemali, P.27/1, u paraqiten palet kontraktuese, si me poshte : -----

SHITESI : Multigaz Est Srl, person juridik italian, perfaqesuar nga z. Maurizio Colombo, n. pasaporte 005244 N, pronare e 19.464,668 pjeseve te kapitalit ose 96,36 % te tij, ne shoqerine Sofigaz sh.p.k., Tirane, person juridik shqiptar i njohur dhe regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes; -----

BLERESI : Ardian Rushit Strazimiri, lindur ne Tirane, me 01.06.1957, n. leter - njoftimi UG 016779, ortak ne shoqerine Sofigaz sh.p.k., me 735,332 pjese kapitali ose 3,64 % te tij; -----

te gjithe persona madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat perkatese te identifikimit, te cilet, me vullnetin e tyre te lire, duke u bazuar edhe ne vendimet e Asamblese se Ortakeve te dates 30.09.2001, kerkuan redaktimin e kontrates se shitjes se pjeseve te kapitalit, me kushtet e meposhtme: -----

Multigaz Est Srl eshte ortak ne shoqerine "Sofigaz" sh.p.k., person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes me n. vendimi 15470 date 19.07.1996, dhe zoteron 19.464,668 (nentembedhete mije e katerqint e gjashtedhete kater presje gjashteqint e gjashtedhete tete) pjese nga kapitali themeltar i kesaj shoqerie ose 96,36 % te tij dhe i shet z. Ardian Strazimirit 1.284,668 pjese kapitali ose 6,36 % te tij. -----


Çmimi i shitjes se tyre perfaqeson fitimin e ortakut A.Strazimiri per vitin 2003, sipas miratimit te Asamblese se Ortakeve te dates 30.09.2001, pika 4 e rendit te dites, germa a, ku lejohet ky i fundit te perdore fitimin e tij per blerjen e pjeseve te kapitalit deri sa te arrije 10 % te krejt kapitalit themeltar. -----

Shitesi garanton Bleresin qe pjeset e kapitalit, objekt i kesaj kontrate, jane plotesisht te disponueshme, te transferueshme dhe te lira nga çdo lloj pengu, ipoteke apo barre tjeter ligjore. -----

Lidhur per sa me siper, bleresi Ardian Strazimiri, pervec pjeseve te kapitalit qe zoteron tashme ne shoqerine "Sofigaz" sh.p.k., behet pronar edhe i pjeseve te mesiperne duke u bere ortak me 2.020,000 pjese kapitali ose 2.020.000 Leke ose 10 % te kapitalit. -----

Kontrata perpilohet ne nje faqe dhe tre kopje origjinale dhe ne baze te vullnetit te lire dhe te plote te personave pjesmarres. Pasi lexohet me ze te larte, perkthehet njekohesisht nga une ne italisht per perfaqesuesin e huaj, deklarohet se eshte kuptuar, miratohet dhe firmoset rregullisht prej tyre dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit. ---

Per, SHITESIN
Maurizio Colombo


MAURIZIO COLOMBO



BLERESI
Ardian Strazimiri

